



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA/ GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), shpall thirrjen e parë të hapur për dorëzimin e aplikacioneve për grante dhe mbështetje për zhvillimin e biznesit për **personat e pa punë me ide biznesi unike**, në kuadër të Programit të Vetëpunësimit (Programi), i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës, MPMS e Kosovës dhe UNDP.

Rreth Programit të Vetëpunësimit

Qëllimi i Programit të Vetëpunësimit është të mbështesë krijimin e planeve të realizueshme të biznesit që janë në gjendje t'i mbijetojnë tregut konkurrues duke promovuar Vetëpunësimin si masë aktive të tregut të punës. Përveç mbështetjes me grant, Programi do të ofroj trajnime për shkathësi në zhvillimin e biznesit dhe këshilla për t'i ndihmuar personat e papunë me kualifikime dhe orientuar për të qenë të suksesshëm në fushën e zgjedhur. Programi i prezentuar i Vetëpunësimit është program konkurrues për të garantuar kthimin më të lartë të mundshëm të investimit. Procesi i përzgjedhjes ka për qëllim të sigurojë transparencë dhe konkurrencë të drejtë dhe t'i mbështesë idetë dhe planet më të mira të biznesit që garantojnë rezultate të qëndrueshme.

Faza pilotuese e Programit do të zbatohet në **Prishtinë, Prizren dhe Gjilan** dhe nuk do të ketë kuota rajonale që kufizojnë numrin e aplikantëve apo shumën e financimit që do të shfrytëzohet në secilin rajon.

Mbështetja nga programit

Qëllimi i Programit është që të sigurojë mbështetje hap-pas-hapi për idetë e biznesit që kanë mundësinë më të madhe të arrijnë sukses dhe të përballen me barriera të ndryshme të tregut. Për këto qëllime Programi është ndarë në dy faza.

Faza e parë: Pjesëmarrësit e kualifikuar fillimisht aplikojnë me **idenë e tyre të biznesit**, përmes **Formularit të aplikimit për ide të biznesit**. Aplikantët e aprovuar do të marrin pjesë në trajnimin për zhvillimin e planit të biznesit (10 ditë pune me gjysmë orari). Trajnimi do të

fokusohehet në zhvillimin e aftësive të biznesit, kërkimin për mbështetje të tjera financiare, dhe do të ofrohen konsultime me ekspertë të njohur nga kjo fushë.

Faza e dytë: Aplikantët që kalojnë me sukses trajnimin, zhvillojnë **biznes planet** e tyre dhe përfundimisht konkurrojnë për mbështetje të grantit dhe mbështetje të zhvillimit të biznesit.

Sektorët ekonomik të pranueshëm

Veprimtaritë e pranueshme të biznesit janë nga gjashtë sektorët vijues, të përzgjedhur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), si sektorët me potencialin më të lartë për zhvillim ekonomik në Kosovë:

- industria e përpunimit dhe paketimit të ushqimit;
- TIK krahas me kontraktimin e jashtëm të proceseve të Biznesit dhe sektori i qendrave të mbështetjes për konsumatorë;
- industria e përpunimit të metalit;
- industria e tekstilit;
- turizmi;
- industria e përpunimit të drurit.

Idetë e biznesit të pa pranueshme për të marrë pjesë në Program janë:

- të gjitha llojet e veprimtarive në kuadër të sektorit primar të bujqësisë;
- veprimtaritë me patundshmëri, lizing;
- veprimtaritë financiare dhe të sigurimeve dhe veprimtaritë që përfshijnë bixhozin;
- prodhimi i pijeve me përmbajtje të lartë të alkoolit dhe rakisë;
- prodhimi i produkteve të duhanit;
- prodhimi dhe shpërndarja e armëve;
- prodhimi që përdorur teknologji që çojnë në ndotje të mjedisit (si ndotje të ajrit, ujit, tokës etj.).
- bizneset joformale nuk do pranohen për aplikim.

Luteni të shihni listen e KLASIFIKIMIT TE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE: https://ask.rks.gov.net/images/files/Klasifikimi%20i%20Veprimtarive%20Ekonomike%20NECA%20Rev_%202.pdf

Aplikantët e pranueshëm

Të gjithë aplikantët **duhet të kenë në ide të biznesit** për të nisur një biznes mikro apo të vogël të pavarur. Ata janë të obliguar që personalisht të marrin pjesë në fazat e Programit dhe të jenë drejtpërsëdrejti të përfshirë në zhvillimin dhe realizimin e biznesit.

Kandidatët e kualifikuar dhe pjesëmarrës në Program **duhet të janë persona të regjistruar si të papunë në Zyrat e Punësimit (ZP)**, në kohën e aplikimit. Të gjithë të interesuarit duhet të regjistrohen në Zyrat e Punësimit në komunat e tyre. Këshilltarët për punësim do të sigurojnë sesione këshillimi gjatë të cilës përcaktohet nëse personi i pa punë do të aplikoj në këtë Program. Personat e papunë të interesuar për të përfitur nga Programi i Vetëpunësimit mund të aplikojnë një herë brenda një cikli dhe vetëm me një ide të biznesit.

Personat që nuk kualifikohen për aplikim janë ata persona të cilët:

- nuk janë të regjistruar në ZP;
- janë në konflikt të interesit me palë të përfshira dhe vendimmarrës në Program;
- janë punëkërkuar që kanë përfituar nga masa të tjera aktive të tregut të punës gjatë 12 muajve të mëparshëm kalendarik (nga data e aplikimit për Ide të Biznesit).

Personave të papunë të grupeve në vijim do t'u jepet prioritet.

- të papunëve afatgjatë (më shumë se 12 muaj);
- të rinjve (18-29 vjeç);
- grave;
- përfituesve të ndihmës sociale;
- prindërve vetëushqyes;
- personave nga viset rurale;
- personave me aftësi të kufizuara;
- grupeve të pakicave minoritare.

Mbështetja financiare

Programi i Vetëpunësimit gjatë vitit 2015 do të sigurojë ndihmë në grante në vlerë **prej 3,000 deri 6,000 Euro për çdo plan të biznesit të zhvilluar me sukses** që është miratuar në kuadër të procesit të përzgjedhjes, pas fazës së dytë. Mbështetja në grant duhet të shpenzohet brenda gjashtë muajve të parë të veprimtarisë së të biznesit.

Aplikantët që sigurojnë kontribut financiar ekuivalent me së paku 20 për qind të financimit të kërkuar nga granti, do të marrin pikë shtesë (3 pikë prej 100 në total) nga vlerësimi i planeve të biznesit. Nëse kontributi është më i vogël se 20 për qind, nuk do të jepen pikë shtesë.

Aplikantët e miratuar mund të planifikojnë për financim shtesë duke përdorur instrumente financiare (kredi, lizing, grante, etj.) në dispozicion në Kosovë përmes institucioneve financiare ose programeve të financuara nga donatorët. Instrumentet e tilla rekomandohen për zgjerim të mëtejshëm të biznesit që nuk është mbuluar nga plani i biznesit, me mbështetje përmes grantit të këtij Programi.

Përparësi do t'u jepet aplikantëve (deri në 9 pikë prej 100 në total) me ide unike të biznesit (të papërsëritura tek aplikantët tjerë) ose që ofrojnë produkte/shërbime të reja, përdorin zgjidhje teknike dhe teknologji të reja prodhimi dhe/ose që kursejnë energji elektrike, përdorin burime të ripërtëritshme të energjisë, si dhe biznese që krijojnë më shumë se 3 vende pune (vetëm për të papunët e regjistruar)

Kriteret e vlerësimit

Aplikantët me 70% dhe më shumë pikë në Formularët e tyre të Aplikimit do të vazhdojnë në fazën e ardhshme të Programit.

Formulari i aplikimit përbëhet nga:

a) testi i biznesit (me pyetje të shumta) – maksimalisht 35 pikë

b) përshkrim i idesë së biznesit (përshtatshmëria e idesë së biznesit, rendësia e produkteve/shërbimeve të planifikuara) – maksimalisht 45 pikë

Pikë shtesë do të jepen për:

Grupet prioritare – deri në 8 pikë varësisht nga numri i grupeve me përparësi në të cilin aplikanti bën pjesë

Ide Unike– 3 pikë

Produkte të reja/shërbime 2 pikë

Përdorim i teknologjive që kursejnë energji – 1 pikë

Përdorim i burimeve të ripërtëritshme të energjisë – 1 pikë

Krijimin e së paku 3 mundësive të reja të punësimit – 2 pikë

Bashkëfinancim vetanak (së paku 20% të grantit të kërkuar) – 3 pikë

Shpenzimet e pranueshme

Shpenzimet e pranueshme që mund të mbulohen nga paratë e grantit duhet të shfrytëzohen për zbatimin e planit të biznesit dhe mund të përfshijnë:

- qeraja e lokaleve për zyre apo veprimtari të biznesit;
- blerjen e materialeve për rinovim apo përshtatje të lokaleve/objekteve për biznesin;
- blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, si dhe softuerit dhe aseteve të tjera jo të prekshme;
- blerjen e lëndës së parë para nisjes dhe materialeve të harxhueshme;
- pagat dhe mëditjet, dhe shërbimet e tjera të nevojshme të specializuara (kontabilitet, administratë, TI, etj.);
- promovimin dhe reklamimin e veprimtarive.

Ekzistojnë disa kufizime për shpenzimet e pranueshme:

- deri në 30% të grantit mund të shfrytëzohet për rinovimin e objektit (vetëm për veprimtari hoteliere lejohet deri në 50%);
- blerja e lëndës së parë mund të mbulohet vetëm një herë, si blerje e njëhershme e stokut fillestar;
- pagat dhe mëditjet mund të mbulohen deri në gjashtë muaj pas fillimit të biznesit, bazuar në pagën mesatare në Kosovë; (pjesa tjetër e pagës duhet të mbulohet nga vetë biznesi)
- reklamat mund të mbulohen vetëm për gjashtë muajt e parë pas nisjes së veprimtarisë, deri në 10% të grantit.

Shpenzimet e papranueshme që nuk mund të mbulohen nga granti përfshijnë:

- blerjen e patundshmërive (tokë, ndërtesa, etj.)
- blerjen e mjeteve transportuese që nuk do të shfrytëzohen drejtpërsëdrejti për veprimtarinë e biznesit të propozuar;
- çdo shpenzim që nuk është i lidhur me biznesin e propozuar;
- shpenzimet e bëra para lidhjes së kontratës për grantin.

Shpenzimet e papranueshme në kuadër të grantit mund të mbulohen nga kontributi personal i aplikantit. Të gjitha shpenzimet e tjera të rëndomta dhe të domosdoshme për biznesin do të

mbulohen nga aplikanti.

Si të aplikoni

Të gjithë personat e interesuar që plotësojnë kushtet për aplikim të kompletojnë **Formularin e aplikimit për ide të biznesit** dhe ta dorëzojnë atë në Zyrën e Punësimit ku ai/ajo është i/e regjistruar, **në një origjinal dhe tri kopje të tjera identike**, në shqip apo serbisht. Aplikantët janë të obliguar të sigurojnë si bashkëlidhje në *Formularin e Aplikimit CV-në e tyre dhe* të gjitha dokumentet që dëshmojnë shkollimin, kualifikimin dhe përvojën e tyre që përputhet me idenë e paraqitur të biznesit.

Aplikimit për ide të biznesit mund të dorëzohet **në Zyrën me të afërt të Punësimit ku aplikuesi/ja është regjistruar si i/e papunë**. Formulari i plotësuar i Aplikimit me dokumentet e bashkëlidhura duhet të dorëzohet personalisht në Zyrën përkatëse të Punësimit brenda orarit të punës të ZP-së.

Çdo aplikacion i dërguar pas aftatit të fundit të shpallur konsiderohet i pavlefshëm. Data e fundit e dorëzimit të aplikimeve është 22 Maj 2015, në orën 16:00.

Secili aplikant mund të aplikojë me vetëm një ide të biznesit.

Informata të tjera

Informata shtesë dhe Formulari i Aplikimit mund të gjenden në www.mpms.rks-gov.net dhe secilën Zyre të punësimit në rajonet e **Prishtinës, Prizrenit** dhe **Gjilanit**. Për më shumë informata në komunën tuaj, ju lutem kontaktoni Zyrat e Punësimit ë adresat në vijim:

| Zyrat e Punësimit | Adresa | Tel |
|--------------------------|-------------------------------------------------------|--------------------------------------|
| Prishtinë | Rr. "Tirana" | 038 / 613 - 021 |
| Podujevë | Rr. "Hyzri Talla" | 038 / 570 - 014 |
| Fushë Kosovë | Rr. "Nene Tereza" | 038 / 535 - 197 |
| Obiliq | Rr. "Ferid Curi" | 038 / 560 - 184 |
| Lipjan | Rr. "Gjergj Fishta" | 038/ 581-011 |
| Glllogoc | Rr "Fehmi Gjeve Lladrovci" | 038 / 584 - 260 |
| Novobërdë | Boston Village | 038 / 576-016 |
| Graçanicë | Ndërtesa e Qendrës Sociale Llplashellë/Laplje Selo | 045/413 - 171 |
| Gjilan | Rr. "Idriz Seferi" | 0280 / 320 - 057 0280 / 328 - 345 |
| Kamenicë | Rr. "Nëna Tereze" | 0280/372-383 |
| Viti | Rr. "Preshevës" | 0280/381-048 |
| Prizren | Rr. "Zahir Pajaziti". Nr.1 | 029 / 241 - 349 029 / 222 - 223 |
| Suharekë | Rr. "Brigada". Nr. 123 | 029 / 271 - 029 |
| Rahovec | Rr. "Abdullah Bugari" | 029 / 276 - 480 |
| Dragash | Rr. "Sheshi i dëshmorëve" | 029 / 281 - 075 |

Ne rast se keni pyetje shitesë për programin e Vetëpunësimit, ju lutem kontaktoni Zyren e ALMP, nëpërmjet postës elektronike: almp.ks@undp.org.

Informatë e shkurtër rreth Projektit:

Objektiva kryesore e Programeve Aktive të Tregut të Punës (ALMP) është të përmirësojë kapacitetet e insitucioneve të punësimit duke dizajnuar politika te përshtatshme, me ndjeshmëri gjinore, në nivel qendror, dhe për të ofruar shërbime të integruara në nivelin lokal, duke u fokusuar në grupet e marginalizuara në mes të të papunëve. Gjatë viteve 2014-2017, ALMP mbështetet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës, Qeveria e Kosovës dhe UNDP.

Data të rëndësishme

- Dorëzimi i biznes ideve: **22 Maj 2015**
- Shpallja e rezultateve për biznes idetë më të mira: **5 Qershor 2015**
- Trajnimi për përgatitjet e biznes planeve: **10 – 24 Qershor 2015**
- Testi me shkrim pas trajnimit: **29 Qershor 2015**
- Dorëzimi i bizes planeve: **10 Korrik 2015**
- Shpallja e rezultateve finale: **3 Gusht 2015**

Të gjitha informatat do të shpallen në secilën zyrë për punësim dhe në faqen zyrtare në internet të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Sesione informuese në zyrat për punësim do të mbahen në datat si më poshtë:

| Komuna | Data Takimit | Ora | Vendi Takimit | Tel |
|--------------|--------------|-------------|--------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|
| Prishtinë | 22.04.2015 | 09:00-12:00 | Zyra Punësimit Prishtinë Rr. "Tirana" | 038 / 613 - 021 |
| Fushë Kosovë | 22.04.2015 | 13:00-15:30 | Zyra e Punësimit Fushë Kosovë Rr. "Nene Tereza" | 038 / 535 - 197 |
| Obiliq | 23.04.2015 | 09:00-12:00 | Zyra e Punësimit Obiliq Rr "Ferid Curi" | 038 / 560 - 184 |
| Lipjan | 23.04.2015 | 13:00-15:30 | Zyra e Punësimit Lipjan Rr . "Gjergj Fishta" | 038/ 581-011 |
| Podujevë | 24.04.2015 | 09:00-12:00 | Zyra e Punësimit Podujevë Rr. "Hyzi Talla" | 038 / 570 - 014 |
| Glllogoc | 24.04.2015 | 13:00-15:30 | Zyra e Punësimit Glllogoc Rr "Fehmi Gjeve Lladrovci" | 038 / 584 - 260 |
| Novobërdë | 27.04.2015 | 09:00-12:00 | Zyra e Punësimit Novobërd ,Fshati Boston | 038 / 576-016 |
| Graçanicë | 27.04.2015 | 13:00-15:30 | Zyra e Punësimit Graçanicë, Ndërtesa e Qendrës Sociale Llaplasellë/Laplje Selo | 045/413 - 171 |
| Gjilan | 22.04.2015 | 09:00-12:00 | Zyra e Punësimit Gjilan ,Rr. "Idriz Seferi" | 0280 / 320 - 057 0280 / 328 - 345 |

| | | | | |
|----------|------------|-------------|---------------------------------------------------------|------------------------------------|
| Kamenicë | 22.04.2015 | 13:00-15:30 | Zyra e Punësimit Kamenicë,Rr. "Nëna Tereze" | 0280/372-383 |
| Viti | 23.04.2015 | 09:00-12:00 | Zyra e Punësimit Viti,Rr. "Preshevës" | 0280/381-048 |
| Prizren | 22.04.2015 | 09:00-12:00 | Zyra e Punësimit Prizren ,Rr"Zahir Pajaziti". Nr.1 | 029 / 241 - 349 029 / 222 - 223 |
| Suharekë | 22.04.2015 | 13:00-15:30 | Zyra e Punësimit Suharekë,Rr. ."Brigada". Nr. 123 | 029 / 271 - 029 |
| Rahovec | 23.04.2015 | 13:30-16:00 | Zyra e Punësimit Rahovec,Rr . "Abdullah Bugari" | 029 / 276 - 480 |
| Dragash | 23.04.2015 | 09:00-12:00 | Zyra e Punësimit Dragash,Rr."Sheshi i dëshmorëve" | 029 / 281 - 075 |